



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 66, Datë 04.03.2021

MBI

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ANA E ERE-S PËR SHITJEN E 79% TË KUOTAVE
TË SHOQËRISË “SANG 1” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; pikës 6.2, të Licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike; pikës 5.2, të Licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.96, datë 17.06.2016; bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 04.03.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 33/1 prot., datë 01.03.2021 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 08, datë 20.01.2021 dhe me vendimin nr. 09, datë 20.02.2021, ka vendosur të fillojë procedurën përkatësisht për heqjen e licencës nr. 443, seria P19, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., me vendimin e bordit nr. 83, datë 31.05.2019, i ndryshuar, si dhe për heqjen e licencës nr. 447, seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 26.06.2019.
- Vendimet e mësipërme u morën, ndër të tjera, për shkak se rezultoi që shoqëria “SANG 1” sh.p.k. ka shitur 79% të kuotave, pa marrë autorizimin e ERE-s, siç përcaktohet në nenin 6.2, të Licencës së prodhimit të energjisë elektrike, si dhe të pikës 5.2, të Licencës së tregtimit të energjisë elektrike.
- Për vendimin e bordit nr. 08/2021 dhe nr. 09/2021, ERE ka njoftuar shoqërinë nëpërmjet shkresës nr.130 prot., datë 26.01.2021, e cila ka pasur 30 ditë kohë nga marrja e vendimit për t’u përgjigjur dhe dhënë me shkrim argumentet e saj.
- Në lidhje me shitjen e 79% të kuotave, pa marrë autorizimin e ERE-s, siç përcaktohet në nenin 6.2, të Licencës së prodhimit të energjisë elektrike, si dhe të pikës 5.2, të Licencës së tregtimit të energjisë elektrike, shoqëria ka deklaruar se nuk ka kuptuar drejt detyrimin e saj për të marrë

autorizimin e ERE-s përpara ndërrimit të ortakëve kryesore të shoqërisë, për këtë procedurë dhe është mjaftuar me depozitimin e akteve përkatëse në QKB, duke shprehur angazhimin e saj për të mos anashkaluar kompetencat e ERE-s në lidhje me miratimin e ndryshimit të pronësisë mbi kuotat e të licencuarit.

- Shoqëria “SANG 1” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për të marrë autorizimin e ERE-s për shitjen e 79% të kuotave të shoqërisë dhe ka depozituar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të marrë këtë autorizim nga ERE.
- Shoqëria “SANG 1” sh.p.k. ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa i përket pagesave rregullatore.
- Shoqëria angazhohet gjithashtu se do të zbatojë me korrektësi në vijim detyrimet që rrjedhin nga licencat përkatëse për të njoftuar ERE-n brenda afatit për çdo ndryshim të adresës, administratorit apo drejtuesve të saj.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s për shitjen e 79% të kuotave të shoqërisë “SANG 1” sh.p.k.
2. Dhënia e autorizimit nga ana e ERE-s, sipas pikës 1 të këtij vendimi, nuk e zhvesh shoqërinë “SANG 1” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë miratimin nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), nëse kjo kërkohet nga Ministria.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative, Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI